

V E N D I M

“PËR VENDOSJE SEKUESTRO PREVENTIVE”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë prej:

GJYQTARI: ASTRIT FAQOLLI

Me sekretare **NAJADA MUSTAFA**, në Tiranë me datën **08.07.2015**, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura, çështjen penale Nr. që i përket:

KËRKUES: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me prokurore seance **Sonila Muhametaj**.

OBJEKTI: Heqjen e sekuestros preventive, të vendosur me vendimin nr..... akti datë 08.05.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke urdhëruar zhbllokimin e llogarive bankare të shtetasit Italian I. M. G. A. P., në bankat e nivelit të dytë në Shqipëri, përkatësisht: Në Nr.Llogarie (IBAN) AL.....101 762 EUR, pranë **Raiffeisen Bank, për shumën 411.835.78 EURO**, Në Nr.Llogarie (IBAN) AL.....000 2 EUR, pranë **ProCredit Bank, në shumën 356.643.25 Euro**, Në Nr.Llogarie (IBAN) AL.....834, pranë **Bankës Kombëtare Tregtare, në shumën 438.032.71 Euro**.

KUNDËR: **M. G. A. P.**, i biri i F., i datëlindjes 21.12.1964, i identifikuar me pasaportë YA.....7, me adresë V.....Nr.2 ,...., Itali, përfaqësuar në gjykim nga Avokat **Alban Brengasi** mbajtës i Liç me Nr. 3976 dhe NIPT L 01306082 J bazë të prokurës së posaçme me Nr. 3642 Rep dhe Nr 528 Kol date 14.05.2015.

IDYSHUAR: Për veprën penale të “**Pastrim i produkteve të veprës penale ose i veprimtarisë kriminale**”, parashikuar nga Neni 287 i K. Penal.

Në përfundim të shqyrtimit të çështjes në prani të prokurores e cila kërkoi: “Heqjen e sekuestros preventive, duke urdhëruar zhbllokimin e llogarive bankare të shtetasit Italian M. G. A. P., në bankat e nivelit të dytë në Shqipëri”, mbrojtësin e shtetasit Italian Av. Alban

Bengasi i cili kërkoi – pranimin e kërkesës së prokurorisë, gjykata pasi shqyrtoi kërkesën dhe u njoh me provat e administruara në seancë gjyqësore:

V Ë R E N

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka paraqitur për shqyrtim kërkesën për heqjen e sekuestro preventive të vendosur me vendimin nr..... akti datë 08.05.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke urdhëruar zhbllokimin e llogarive bankare të shtetasit Italian M. G. A. P., në bankat e nivelit të dytë në Shqipëri.

Rezultoi se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin Nr....., datë 08.05.2015, ka vendosur vënien e sekuestros preventive me afat 2 mujor mbi llogaritë bankare të shtetasit Italian M. G. A. P., në bankat e nivelit të dytë në Shqipëri, përkatësisht: Në Nr.Llogarie (IBAN) AL.....101 762 EUR, pranë **Raiffeisen Bank, për shumën 411.835.78 EURO**, Në Nr.Llogarie (IBAN) AL.....000 2 EUR, pranë **ProCredit Bank, në shumën 356.643.25 Euro**, Në Nr.Llogarie (IBAN) AL.....834, pranë **Bankës Kombëtare Tregtare, në shumën 438.032.71 Euro**.

Kjo masë sekuestro është vendosur pasi më datë 07.05.2015 Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka regjistruar procedimin penale Nr., për veprën penale të “Pastrim i produkteve të veprës penale ose i veprimtarisë kriminale” parashikuar nga Neni 287 i K. Penal, në ngarkim të shtetasit I. M. G. A. P.. Rrethanat dhe kushtet për të cilat është marrë kjo masë janë parashtruar në vendimin nr..... datë 08.05.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Prokurorja e seancës parashtroi se: Nga hetimi paraprak i bërë nga prokuroria, ka rezultuar se në emër të shtetasit Italian M. G. A. P. nuk ka të regjistruar pasuri si të luajtshme dhe të paluajtshme si dhe aktivitetet biznesi në Republikën e Shqipërisë.

Gjithashtu nga konfirmimi i marrë nga Zyra Qëndrore e Interpol Tirana dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë ka rezultuar se në ngarkim të shtetasit Italian M. G. A. P. nuk figuron i regjistruar për veprimtari kriminale apo o evidentuar si shtetas me precedentë penal.

Shtetasi Italian M. G. A. P. rezulton të jetë me profesion muzikant si kompozitor, pianist dhe drejtor orkestre si dhe ka krijuar Fondacionin “U.....”. Ai ka marrë pjesë në shumë koncerte në vende të ndryshme të botës dhe të ardhurat i ka deklaruar tek fondacioni në Itali me emrin “U.....”. Ai bashkëjeton me shtetasen Shqiptare S. M., me profesion violiniste që nga viti 1998 kur ka ardhur për herë të parë në Shqipëri.

Përveç të ardhurave nga puna e tij si muzikant ai ka të dhuruara nga nëna e tij V. S. e cila jeton në Itali pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme të fituara ndër vite pas ka patur një fondacion me emrin “H.....” me seli në Zvicër. Këto pasuri dhe llogari bankare janë të dhuruara në vitin 2010 dhe një pjesë e këtyre pasurive (llogari bankare) janë sekuestruar nga Gjykata, pasi pasuria që ai disponon është më e madhe.

Nga provat e mara rezulton se nëna e shtetasit Italian M. G. A. P., e quajtura V. S. me kontratën e dhurimit të datës 12.01.2010, i dhuron atij pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme që ndodhen në Zvicër. Nga dokumentat bankare të lëshuar nga “Luzerner Kantonalbank” Zvicër, rezulton shuma 3.104.294,67 Euro që i perket Fondacionit “H.....” e cila si përfituese e parë është nëna e shtetasit Italian M. G. A. P., V. S., e cila ia ka dhuruar djalit të saj shtetasit Italian M. G. A. P.. Nga kjo llogari është bërë dhe transferimi i shumës prej 1.500.000 Euro në bankat shqiptare me qëllim investimin e tyre në fushën e muzikës dhe në pasuri të paluajtshme.

Duke qenë se kjo shumë e sekuestruar nuk është produkt i veprave penale ose i veprimtarisë kriminale, organi i prokurorisë kërkon heqjen e sekuestros preventive të vendosur me vendimin nr..... datë 08.05.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ndaj llogarive bankare të shtetasit Italian M. G. A. P. në bankat e nivelit të dytë në Shqipëri.

Gjykata, pasi shqyrtoi provat e paraqitura nga organi i prokurorisë, si dhe kur vetë ky organ nuk kërkon mbajtjen e sekuestros preventive pasi shuma e sekuestruar nuk është produkt i veprave penale ose i veprimtarisë kriminale, pra rrjedhimisht nuk ka më çështje në ngarkim të shtetasit Italian M. G. A. P., çmon se duhet të pranohet kërkesa e organit të prokurorisë duke hequr sekuestron preventive të vendosur me vendimin nr..... datë 08.05.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

PËR KËTO ARËSYE

Gjykata mbështetur në Nenin 274 të K. Pr. Penale

V E N D O S I

1. Heqjen e sekuestros preventive të vendosur me vendimin Nr. datë 08.05.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë duke urdhëruar zhbllokimin e llogarive bankare të shtetasit Italian **M. G. A. P.**, në bankat e Nivelit të dytë në Shqipëri, përkatësisht në Nr.Llogarie (IBAN) AL.....101 762 EUR, pranë **Raiffeisen Bank** për shumën **411.835.78 EURO**, në Nr.Llogarie (IBAN) AL.....000 2 EUR pranë **ProCredit Bank**, në shumën **356.643.25 Euro**, në Nr.Llogarie (IBAN) AL.....834 pranë Bankës Kombëtare Tregtare, në shumën **438.032.71 Euro**.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë brënda 10 ditëve.
3. U shpall sot më datë **08.07.2015** në Tiranë.

SEKRETARE
NAJADA MUSTAFA

GJYQTAR
ASTRIT FAQOLLI